Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon propozimet ekonomike të paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse propozimet rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përfundimisht nga ky rregull është situata kur

shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

### **23. Krahasimi i propozimeve**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

### **24. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

## **G. DHËNIA E KONTRATËS**

### **25. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e

Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **H. ANKESAT**

- 27. Procedura e ankesës**
1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **I. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 28. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
    - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
    - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
    - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## **SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

- Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje
- Shtojca 2: Ftesa për Propozim
- Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
- Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
- Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
- Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)



**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik* ]

**KËRKESË PËR PJESËMARRJE**

\_\_\_\_\_  
(*Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i*)

[*Data\_\_\_\_\_*]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Procedura e prokurimit: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

## Shtojca 2

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor]

### **FTESE PËR PROPOZIM**

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

---

**Procedura e Prokurimit:** \_\_\_\_\_

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e parë, jeni kualifikuar për në fazën e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë \_\_\_\_\_ (emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :**

**Data, ora dhe adresa**

Data: □□/□□/□□□□(d/m/v) ora □□:□□

Adresa: \_\_\_\_\_

**Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip

Anglisht

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
  
- (b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].
  
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
  
- (d) Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.
  
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

e) Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik* ]

**FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK**

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës :** (Nëntotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** (Nëntotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** (Nëntotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** (Nëntotali i detajuar)

**TOTALI**

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]  
Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]  
Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]  
Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

## Shtojca 6

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula



## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit<sup>2</sup>**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

---

<sup>2</sup> Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **Shiko dokumentacionin e ngarkuar ne SPE**

## Shtojca 9

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: “Hartim projekti për Port House dhe rehabilitim i Godinave Historike ADM”

**Afatet e ekzekutimit:** 5 (pesë) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës


- **Shiko dokumentacionin ngarkuar ne SPE**

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

- **Shiko dokumentacionin ngarkuar ne SPE**

## Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit<sup>3</sup>.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5*

c. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

---

<sup>3</sup> Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

### 2.2.1

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 %** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022, (Bilancet të parqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e tre viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitet 2021 dhe 2022.

**Shenim.** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të B.O.E, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për detyrimet e maturuara për vitet 2021 dhe 2022, sipas të dhënave të QKB-së. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e maturuara për vitet 2020 dhe 2021 të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

## 2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës pa TVSH të objektit të prokurimit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturën kontratës përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate

- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturën kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate.

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:**

### **LICENCA DHE CERTIFIKIME PROFESIONALE TË KOMPANIVE PROJEKTUESE DHE STAFIT**

#### **Licenca**

Subjektet Projektuese, pjesmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçensa në Projektim, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për liçensimin profesional të

individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Pë ofertuesit e huaj, në zbatim të dispozitave ligjore më sipër, duhet të kenë të ekuivalentuar licensën sipas licensimit të Legjislacionit Shqiptar.

- **Kat 2- PROJEKTIM ARKITEKT**

Pika a. Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike;

Pika c. Projektim Interiere.

Pika d. Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

- **Kat 3 - PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

Pika a, d - (a- Projektim objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate; d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.)

- **Kat 4 - PROJEKTUES INSTALATOR**

Pika a,b,c,e,f,g,h,j (a- Projektim të instalimeve hidro-termosantare. b- Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si edhe të impianteve të prodhimit të energjisë termikënga burime të rinovueshme, c) Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit. h) Projektimi i impianteve ngritëse të transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj. j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.)



- **Kat 5 - PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE**

Pika b,c (b - Projektim furnizim me uje kolektore shkarkimi, c- Projektim ujesjelles kanalizime urbane – rurale)

- **Kat 6 PROJEKTUES RRUGË-HEKURUDHA**

a) Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b- Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

- **Kat 8 - PROJEKTUES GJEODET**

Pika a - Rilevim Inxhinjrik

- **Kat 9 - STUDIM GJEOLGO INXHINJRIK – HIDROGJEOLGJIK**

Pika a - Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinjrik i truallit per objekte civile –ekonomike deri 5 kate

Pika c - Studim/vlerësim gjeologo-inxhinjrik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha

Pika e - Studime e projektme hidrogjeologjike.

- **Kat 10 – PROJEKTIM I IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHE SHPERNDARJES SE ENERGIJE ELEKTRIKE**

Pika c – Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.

Pika e – Projektim kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – mesem.

**Kat 11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR**

a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime

b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

d) Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukture.

**Kat 12 . STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE**

b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore. c- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

d- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse, si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.

e- Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

f- Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

*Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysh vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.*

*(Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të bëjë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit shtetëror kompetent Shqiptar, konform VKM 759, date 12.11.2014, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016.)*

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale, CV dhe libreze pune të vërtetuar në listpagesa:**

- 1 (nje) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Infrastruktura
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Civile Industriale
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Sizmiolog/Gjeofizik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik i kualifikuar fitues, duhet të dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (sipas shtojcës 7)*

#### **2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre të vertetur me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, certifikata dhe kualifikime të vertetuar në listapagesa si mëposhte :**

- 1 (një) Auditues Energjistik i Certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për auditime në Ndërtesa i cili duhet të figurojë në listapagesa për periudhën ***Qershor 2022 – Maj 2023***, të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomat (te vlefshme), dhe licenca leshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë
- 1 (një) ekspert mjedisi të pajisur me certifica të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe Licence III 2 A (1+2) “Per ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate si dhe të figurojnë në listapagesat e shoqërisë për periudhën ***Qershor 2022 – Maj 2023***.
- 1 (një) ekspert MNZ për “Studime dhe përgatitje të projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri në ndërtesa të cdo lloji”, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate si dhe të figurojnë në listapagesat e shoqërisë për periudhën ***Qershor 2022 – Maj 2023***.

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar fitues, duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7).*

**2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 20 (njetete) personave, për periudhën Qershor 2022 – Maj 2023 të vërtetuar me:**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën *Qershor 2022 – Maj 2023*;
- Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për *Qershor 2022 – Maj 2023* shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit, ku të deklarohej disponimi i punonjësit të sipërcituar.

**2.3.6 Certifikata që duhet te kete operatori ekonomik:**

- Shoqëria duhet te paraqese Certificate ISO 9001- 2015 (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objektin e kontrates, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 50001-2011 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i menaxhimit të Energjisë.
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sisitemi i Menaxhimit të Mjedisit, për florën dhe faunën.
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO/IEC 27001: 2013 (e vlefshme) ose ekuivalente: Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit për arsye të objekteve të rëndësisë së veçantë.
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001: 2012 (e vlefshme) ose ekuivalente: Menaxhimi i Logjistikës së Personelit në lidhje me Aktivitetet e Projektimit, Mbikqyrjes dhe Kolaudimit të Punimeve Inxhinierike;

Ne rastet e bashkimit te operatoreve , secili operator ekonomik duhet te paraqese certifikaten sipas fushes se veprimtarise se marre persiper ne marreveshjen e bashkimit te operatoreve ekonomik.

**2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqesë me anë të një deklarate listën e personelit të nevojshëm që do të realizojë objektin e kontratës si dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.**

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*

Bazuar në njoftimin e APP me nr.5585 prot, datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe rekomandimit të APP me nr.6559 prot, datë 27.06.2018, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë parasysh sa më poshtë:

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Vlera limit (fondi limit), është vlera maksimale e llogaritur me vlerat e tarifave maksimale për grupin përkatës.

***Të gjitha ofertat me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen. Gjithashtu, të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e perlllogaritur mbi bazen e parashikimeve të VKM 354 në fjalë, do të skualifikohen.***

***Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publikë, t'i certifikojnë ato me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.***

**Shtojca 12**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme).**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet për t’u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
